



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 425/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Bajrush Hoti nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Malishevë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

## V E N D I M

- I. **Miratohet** si e bazuar ankesa e Kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Bajrush Hoti, nga radhët e subjekti politik LDK, dega në Malishevë,
- II. **Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik LDK në Vendvotimin (VV) 3008A/04D, 3020/02D, 3029A/01R, 3031A/01R/02D, 3034A/01R, 3036A/01R/03R, 3038A/01R, 3042A/01R, 3046A/02D, 3047A/01R, 3048A/01D, 3049A/01D, 3050A/02D, 3051A/01D, 3052A/ 01R.
- III. **Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutive të votimeve të VV si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

## A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës-Bajrush Hoti me nr. 80 nga radhët e subjektit politik LDK dega në Malishevë, me të cilën pretendon se duke u bazuar në të dhënat e formularëve të rezultateve të kandidatëve të KKZ-së në Malishevë dhe formularëve të rezultateve zgjedhore të lëshuara nga Demokracia në Veprim dhe mospërputhshmërisë së këtyre rezultateve nga këta dy formular, konstaton se është manipuluar me votën e tij si kandidat me deputet nga radha e LDK-së dega në Malishevë.

Parashtuesi i ankesës në cilësinë e provës ka ofruar: Formularët e rezultateve zgjedhore të verifikuara nga KKZ-ja në Malishevë dhe Formularët e Rezultateve

zgjedhore të verifikuara nga Demokracija në Veprim për procesin zgjedhor në Komunën e Malishevës.

Formularët e Rezultateve të Kandidatëve të ofruara nga parashtruesi i ankesës lidhur me rastin në fjalë janë formularët e vendvotimeve me numër 3008A/04D, 3020/02D, 3029A/01R, 3031A/01R/02D, 3034A/01R, 3036A/01R/03R, 3038A/01R, 3042A/01R, 3046A/02D, 3047A/01R, 3048A/01D, 3049A/01D, 3050A/02D, 3051A/01D, 3052A/01R.

Ankuesi pretendon se në formularët e vendvotimeve e sipër cituara, rezultatet e votimeve janë të vërtetuar me dyshime të bazuara për manipulim të numrit të votave të kandidatëve me nr. 32 dhe me nr. 80 nga radhët e LDK-së. Sipas parashtruesit të ankesës nga provat e sipër cituara shihet se ka pas shpërdorime të numërimit dhe tregimit të rezultateve të votave, në veçanti për kandidatë që mbajnë numra votues 32 dhe 80 nga radhët e subjektit politik LDK dhe kërkon nga PZAP që pas shqyrtimit të provave të ofruara të bëjë rinumërimin e të gjitha kutive votuese për vendvotimet e Komunës së Malishevës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

#### **ankesa është e bazuar**

PZAP-i, shqyrtoj provat nga shkresat e lendes, duke mos marr parasysh rezultatet nga Demokracia ne Veprim, nga se për PZAP-in ato nuk janë të obligueshme, dhe konstatoj se ka mospërputhje të rezultateve siç shihet nga Formularët e lartpërmendur, dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor me ç'rast është vërejtur se ka parregullsi në mes formularëve të rezultateve të kandidatëve dhe rezultatit përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, i cili rezultat konsiston ne mospërputhjen.

PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotime të lartcekura.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
A nr. 425/2014 më datën 30.06.2014.



#### **Udhëzim Juridik:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*